




# HIV/AIDS NË SHQIPËRI



International  
Planned Parenthood  
Federation





# HIV/AIDS NË SHQIPËRI

Shqipëria vazhdon të ketë një prevalencë të ulët të epidemisë së HIV-it me afro **1400 raste**

Një pjesë e madhe (rreth 80%) e personave të infektuar (HIV/AIDS) besohet se e kanë marrë infekzionin jashtë Shqipërisë. **Shpërndarja gjeografike e HIV** - Epidemia e HIV-it është e përqendruar në kryeqytetin e Tiranës, ku jeton mbi një e katërtë e 2.9 milionë banorëve shqiptarë. Në përgjithësi, 48% e të gjitha testeve për HIV janë kryer në bashkinë e Tiranës, e ndjekur nga qytetet e Durrësit dhe Elbasanit, Shkodra dhe qyteti bregdetar i Vlorës, në jug të Shqipërisë.

## Mënyrat e transmetimit

Megjithëse reastet e të dhënave të raportuara tregojnë disa informacione për rrugët e transmetimit, përsëri ato nuk jepin informacion të saktë për ndonjë rrezik specifik, veçanërisht tek ata persona që konsiderohen se kanë marrë HIV në rrugë heteroseksuale. Në vitin 2018, mënyra mbizotëruese e transmetimit u reportua si heteroseksuale (89.2%), por fakti që pothuajse tre të katërtat e rasteve të HIV-it ishin meshkuj, si dhe fakti që ka një numër relativisht të lartë të çifteve sero-diskorduese, mund të tregojnë se transmetimi nga burrat tek burrat (bazuar në të dhënat e raportuara në 2018) është nën-raportuar – ndoshta për shkak të stigmës së fortë dhe diskriminimit ndaj burave që shkojnë me burra. Transmetimi nga nëna tek fëmija është raportuar në 2%, ndërsa transmetimi nga transfuzioni i gjakut është raportuar më pak se 1%. Më pak se 1% e rasteve me HIV i atribuohen përdorimit të drogës me injektim.





# HIV/AIDS NË SHQIPËRI

## Popullata Kyçë

Të dhënrat e studimit BIO-BSS të kryera në 2011 dhe 2019 kanë zbuluar nivele të ulëta të infekzionit HIV tek popullata kyçë, megjithëse prevalenca e HIV ishte rritur pak në 1.4% midis personave që injektojnë drogë dhe 2.0% midis burrave që shkojnë me burra në 2019. Midis më shumë se 100 punonjëseve të seksit femra të testuara, eshtë gjetur vetëm një rast HIV pozitiv. Megjithatë, rezultatet e studimit IBBS kanë treguar gjithashtu se sjelljet me rrezik të lartë ishin të pranishme në të gjithë popullatën kyçë, veçanërisht në mesin e personave që injektojnë drogë dhe burrave që shkojnë me burra.

## Parandalimi i HIV tek Popullata Kyçë (Punonjëset e Seksit Femra)


Zbatimi i ndërhyrjeve për punonjëset e seksit femra – Shërbimet parandaluese për punonjëset e seksit femra ofrohen vetëm në Tiranë, nga dy OJF, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe

Zhvillimin dhe Aksion Plus. Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin ofron mjetet parandaluese (prezervativë, lubrifikantë dhe materiale IEC), si dhe këshillim psikologjik për klientët. Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin ka një qendër për punonjësit e seksit femra të dizenjuar si një vend i sigurt, konfidencial për ta, e cila ofron një sërë shërbimesh si

këshillim; testimi për HIV, Hepatitis B dhe C, Gonorrean dhe Klamidian; shpërndarje të prezervativëve dhe referimin për shërbime të tjera. Për shkak të specifikës së punës me këtë popullsi, nuk është bërë ende i mundur ofrimi i shërbimeve nëpërmjet krijimit të qendrave të veçanta në rrethet jashtë Tiranës.

Aksion Plus ofron shërbime në terren për punonjësit e seksit femra. Paketat e parandalimit, përfshirë prezervativët, lubrifikantët dhe shiringat të cilat ofrohen nga punonjësit e terrenit që punojnë në Tiranë.

Sfidat mbeten në lidhje me zgjerimin e shërbimeve për punonjëset e seksit jashtë Tiranës. Përveç kësaj, ende nuk është mundësuar dekriminalizimi i punës seksuale.






# HIV/AIDS NË SHQIPËRI

## Parandalimi i HIV tek Popullata në përgjithësi dhe në prioritet

Ndërhyrjet në popullatën e përgjithshme kanë pasur për qëllim organizimin e fushatave ndërgjegjësuese për të rritur testimin për HIV. Për shkak të mungesës së burimeve financiare, zbatimi i këtyre aktiviteteve nuk ka qenë i vazhdueshëm, por vetëm në momente specifike, si java evropiane e testimit për HIV dhe Dita Botërore e SIDA-s. Gjithashtu, në vitin 2019 ka nisur zhvillimi i një strategjie kombëtare të komunikimit.

Popullsia rome dhe egjiptiane – një strategji komunikimi është përgatitur për popullsinë rome. Ndërhyrjet për parandalimin e HIV-it në këtë popullatë përfshinin trajnime për edukatorët si dhe stafin mjekësor në qendrat e komunitetit rom.

Vizioni i Planit Kombëtar të Veprimit për HIV/AIDS 2020-2025 është ZERO transmetim i HIV-it deri në fund të vitit 2025, nëpërmjet një reagimi kombëtar të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ndaj HIV dhe AIDS, i cili i përgjigjet nevojave prioritare të të gjitha popullatave kyçë dhe siguron barazi. të qasjes në parandalimin, trajtimin, kujdesin dhe shërbimet mbështetëse të HIV për të gjithë.






# HIV/AIDS NË SHQIPËRI

Parandalimi i HIV-it është fusha e parë, kryesore prioritare e PlaniT Kombëtar të Veprimit 2020-2025. Fokusi i fortë do të jetë në popullatat kryesore, duke përfshirë personat që injektojnë drogë (PËID), burrat që bëjnë seks me burra (MSM), punonjësit e seksit femra (FSË) dhe klientët e tyre, dhe të burgosurit. Deri më sot, me mbështetjen e Fondit Global janë ofruar paketa shërbimesh gjithëpërfshirëse, duke përfshirë prezervativët, gjilpërat e pastra, shërbimet e IST-ve dhe terapinë e mirëmbajtjes me metadon (MMT). Prevalenca relativisht e ulët e HIV midis këtyre grupeve krahasuar me vendet e tjera nxjerr në pah ndikimin e këtyre shërbimeve dhe rëndësinë e mbajtjes së tyre.

Një sfidë kryesore për gjashë vitet e ardhshme është mbajtja e këtyre shërbimeve për popullatat kryesore pa financim të jashtëm. Në këtë drejtim, modelet aktuale të ofrimit të shërbimeve, të cilat varen shumë nga financimi i jashtëm, duhet të rishikohen në mënyrë që të bëhen më të qëndrueshme.

Përveç këtij fokusi në popullatat kyçë, nevojiten më shumë veprime për parandalimin e HIV në popullatën e përgjithshme. Ndërsa popullatat kyçë janë në rrezik më të lartë të HIV-it, pjesa më e madhe e rasteve të identifikuara rishtazi me HIV duket se janë nga popullata e përgjithshme.

Disa nga këto raste mund të janë MSM të 'fshetur' ose klientë të punonjësve të seksit, por mesazhi është i qartë se nevojitet më shumë vëmendje për parandalimin tek popullata e përgjithshme.



Kjo fletëpalosje u përgatit nga Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin sëbashku me kontributin e anëtarëve të koalicionit të HIV/AIDS, në kuadër të projektit "Shërbimet e

HIV/AIDS dhe Shëndetit Riprodhues dhe Seksual për Popullatat Kyçë në Shqipëri" dhe me mbështetjen e Federatës Ndërkombëtare të Planifikimit Familjar (IPPF).